



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Z. Azem Bujupi
Drejtore
Radio Kosova 1 dhe 2
Prishtinë

Ref:1311/1557/KPM/II

I nderuar z. Bujupi,



Prishtinë, 5 nëntor 2013

Komisioni i Pavarur për Media (KPM), më 30 tetor 2013 ka shqyrtuar kërkesën tuaj lidhur me ndërtimin e rrjetës së tretë për transmetuesin publik – për shërbime të radio programeve. Në bazë të analizave të bëra rreth kësaj kërkeje si dhe kapaciteteve teknike sipas planit të frekuencave në Republikën e Kosovës ju bëjmë me dije se, teknikisht nuk ka mundësi të ndërtohet rrjeti i pestë për mbulim nacional në radio VHF/FM në brezin frekuencor 87.5 - 108 Mhz, pasi që ky brez frekuencor është i kufizuar për ndërtimin e vetëm katër rrjeteve. Sipas Planit Gjeneva 84, ku përfshihen të gjitha vendet e rajonit 1 në nivel botëror, e ku bënë pjesë edhe vendi ynë, i kanë të planifikuara nga katër rrjeta nacionale për shërbime radio programe, të cilat rrjeta, frekuencat e të cilave janë në përdorim, janë të koordinuara dhe të mbrojtura ndërkombëtarisht.

Kështu që, sipas planit Gjeneva 84, Republika e Kosovës i ka të planifikuara katër rrjete me mbulim nacional të cilat aktualisht të gjitha i ka në përdorim për nevojat e shërbimit radiodifuziv të Republikës së Kosovës (Radio Kosova 1 dhe 2, Radio Dukagjini dhe RTV21), dhe në këtë situatë nuk ka asnjë mundësi teknike për ndërtimin e rrjetit të pestë.

Në bazë të situatës aktuale, KPM është e detyruar të refuzojë kërkesën tuaj për ndërtimin e rrjetit të tretë.

Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

Sinqerisht,

Shefki Ukaj
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave